



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 21 tetor 2021, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Ndryshimin e kushteve teknike të licencës së shoqërisë “Radio Klan” sh.a. për transmetime audio analoge kombëtare “Radio Klan”. **(Vendimi nr. 81, datë 21.10.2021)**
2. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “TIBO” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë, nr. 10, datë 27.09.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “TIBO” sh.p.k. për subjektin “TIBO”, në masën 1 000 000 lekë. **(Vendimi nr. 82, datë 21.10.2021)**
3. Refuzimin e ankimit administrativ të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 3, datë 05.05.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) në masën 1 000 000 lekë. **(Vendimi nr. 83, datë 21.10.2021)**
4. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Digit-Alb” sh.a. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 4, datë 05.05.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “Digit-Alb” sh.a., për subjektin “Digit-Alb”, në masën 1 000 000 lekë. **(Vendimi nr. 84, datë 21.10.2021)**
5. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Tring Tv” sh.a. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 5 datë 05.05.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “Tring Tv” sh.a. për subjektin “Tring Tv”, në masën 1 000 000 lekë. **(Vendimi nr. 85, datë 21.10.2021)**
6. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Ora” sh.a. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 6, datë 08.06.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “Ora” sh.a. për subjektin “Tv Ora”, në masën 1 000 000 lekë. **(Vendimi nr. 86, datë 21.10.2021)**
7. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Egnatia Televizion” sh.a. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 8 datë 08.06.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “Egnatia Televizion”

sh.a. për subjektin “Club Tv”, në masën 1 000 000 lekë. (**Vendimi nr. 87, datë 21.10.2021**)

8. Refuzimin e ankimit administrativ të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 9 datë 08.06.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) në masën 1 000 000 lekë. (**Vendimi nr. 88, datë 21.10.2021**)
9. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Johaniter” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë nr. 7 datë 08.06.2021, për shkeljen e të drejtave të transmetimit, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “Johaniter” sh.p.k. për subjektin “MCN Tv”, në masën 1 000 000 lekë. (**Vendimi nr. 89, datë 21.10.2021**)

Organi kolegjal gjithashtu u njoh dhe shqyrtoi projekt Memorandumin e Bashkëpunimit që do të nënshkruhet midis Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 21.10.2021